



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .07.2024

**Lënda:** Përgjigje kërkesës nr 2 të paraqitur nga z. A.S.  
Adresa:  
E-mail :

**TIRANË**

I nderuar z. S.,

Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. 2 për informacion, dërguar me email datë 14.07.2024 dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, me anë të së cilës ngrini shqetësimin se jeni “ informuar pjesërisht pasi nuk jeni njohur me mënyrën e komunikimit të personave kërkues me Autoritetin dhe informacione të detajuara për mënyrën e aksesimit të dokumentacionit në kundërshtim me ligjin nga këta persona anonimë dhe pa lidhje gjenealogjike me viktimat e diktaturës në këto dosje“ ju ri-informojmë se: sipas informacionit të dërguar nga struktura që ka trajtuar praktikën, për mënyrën e komunikimit ju ri-informojmë se pranë Autoritetit, është depozituar një kërkesë e paraqitur nga z. N.N., drejtor i medias Publik Live, nr. 643 prot., datë 03.04.2023 dhe për plotësim dokumentacioni nr. 643/1 prot, datë 27.04.2023 nga z. E.Gj. për qëllime mediatike, në lidhje me një reportazh, me objekt informimi mbi dokumente të krijuara nga ish-Sigurimi i Shtetit në lidhje me A.Gj. dhe B.Gj.. Kërkuesve të informacionit i janë vendosur në dispozicion materialet me Vendimin e Autoritetit nr. 307 datë 8.05.2023. (mënyra e aksesimit të dokumentacionit bazuar në vendimin e Autoritetit).

Sic ju kemi informuar edhe me shkresën tonë të mëparshme këtë vendim ju mund ta gjeni të publikuar edhe në faqen zyrtare të Autoritetit në rubrikën me titull “VENDIME MBI BAZËN E KËRKESAVE PËR QËLLIME STUDIMORE MEDIATIKE”. Për t’ju ardhur në ndihmë po ju dërgojmë bashkëlidhur gjithsesi vendimin e kërkuar në formatin e publikuar në faqe në buletin e vendimeve të muajit maj 2024.

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Sofi Noti**